



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1347 Prot.

Tiranë, më datë 22.12.2020

VENDIM
Nr. 521, datë 22.12.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 22.12.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit të Znj. Edlira Demiraj për mungesën e interesit kulturor për *Monumentin e Kulturës, Kategoria e II-të*, për objektin “*Banesë Tip Vilë 2 kate II-149*”, në Lagjen 7, Rruga “Mihal Duri, Tiranë 8380, relacion i hartuar nga person i licencuar në restaurim Ing. Fatjon Saliu
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

